

është në procedim e sipër në Dhomën e Posaçme nën lëndën SCEL-11-0053 dhe se Paditësi tashmë ka parashtruar një ankesë, të regjistruar nën numrin SCEL-11-0053-C0198. E Paditura thekson se padia për paga të papaguara mujore në bazë të Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren është e parashkruar në pajtim me nenet 371, 373 dhe 379 të LMD-së (Ligji mbi Marrëdhëniet Detyrimore). I Padituri deklaroi se kërkesa e Paditësit për të vërtetuar vlefshmërinë e Vendimit të Këshillit të Punëtorëve për emërimin e tij si drejtor të NSH-së dhe si rrjedhojë e kësaj edhe marrëdhënien e tij të punës është e pabazuar sepse me këtë vendim i ishte shkëputur marrëdhënia e tij e punës.

Gjykata e Qarkut e Prizrenit me anë të njoftimit të datës 2 mars 2011 i ka dorëzuar Dhomës së Posaçme shkresat e lëndës Ac.nr.236/2010 të Gjykatës së Qarkut të Prizrenit (ankesa kundër Vendimit të Gjykatës Komunale të Prizrenit C.nr.999/09, datë 24 shkurt 2010), duke deklaruar se nuk ka juridiksion.

Më 14 qershor 2012 Dhoma e Posaçme tërhoqi lëndën Ac.nr.236/2010 nga Gjykata e Qarkut në Prizren për gjykim në Dhomën e Posaçme.

Në seancën dëgjimore të datës 27 shkurt 2013, Paditësi, pasi që është njoftuar, se një padi për listën e punëtorëve ku ai është Ankues është në pritje për t'u zgjidhur pranë DHPGJS-së (SCEL-11-0053-C0198), ai tërhoqi padinë e tij me anë të së cilës kishte kërkuar që të përfshihet në listën përfundimtare në këtë procedurë SCA-11-0030.

I Padituri edhe pse është këshilluar që duhet të përfaqësohet nga një avokat dhe është paralajmëruar që në rast se nuk përfaqësohet nga një avokat, atëherë do të lëshohet një Aktgjykim në Mungesë, duke nënkuptuar se pala është paraqitur në gjykatë pa një avokat. Ai mendon se Ligji mbi Dhomën e Posaçme, i cili kërkon përfaqësimin me anë të një avokati, është një ligj jo shumë i rëndësishëm në krahasim me Kodin e Procedurës Kontestimore, i cili nuk kërkon një avokat.

Në lidhje me detajet e tjera referimi është bërë në shkresat e lëndës.

Arsyetimi Ligjor

1.

Pretendimet e të Paditurit nuk duhet të merren në konsideratë pasi që ato nuk janë parashtruar nga një avokat.

Pranë Dhomës së Posaçme, të gjitha palët, me përjashtim të personave fizik, duhet të përfaqësohen nga një avokat (Shtojca Neni 24 LDHP 04/L-033). Kjo gjithashtu aplikohet për NSH-të e përfaqësuar nga AKP-ja. Fjalëformimi i kësaj dispozite nuk përmban asnjë indikacion se përse nuk duhet të aplikohet. Neni 73, 74, 85 dhe 86 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (Ligji Nr. 03/L-006, LPK), i cili rregullon se kush mund të jetë palë, çfarë veprime mund të marrë një palë dhe kush mund të përfaqësojë një palë, lejon që palët dhe përfaqësuesit e tyre, të cilët nuk janë të regjistruar si avokatë, të veprojnë pranë gjykatës, por dispozitat e Nenit 24 të Shtojcës së LDHP-së janë *Lex Posterior* dhe *Lex Specialis*. Ligjdhënësi ka krijuar nenin 24 të Shtojcës së LDHP-së në kohën kur LPK tanimë ka qenë duke ekzistuar dhe me anë të Nenit 24 të Shtojcës së LDHP-së ka rregulluar një procedurë të posaçme në një gjykatë të posaçme, e cila është ndryshe nga gjykatat e tjera të Kosovës. Neni 24 i Shtojcës së LDHP-së zëvendëson edhe Nenin 29 të Ligjit për AKP-në (04/L-034, Ligji mbi AKP-në), sepse është nxjerrë më vonë dhe nuk e rregullon përfaqësimin në përgjithësi, siç bën Ligji mbi AKP-në por

në veçanti para DHPGJS-së. Kjo vlen edhe për Nenin 29.2 të Ligji mbi AKP-në i cili rregullon "pozicionin ligjor" të Agjencisë për të ndjekur të drejtat e ndonjë ndërmarrjeje në gjykatën kompetente në emër të ndërmarrjes në fjalë.

Rregullimi ligjor sa i përket asaj që personat fizik nuk kanë nevojë për avokat, por gjithë të tjerët kanë nevojë për avokat nuk shkel Nenin 73 dhe 74 LPK-së. Kjo nuk është e mundur sepse Nenet 73 dhe 74 nuk janë të aplikueshme këtu. Ato zëvendësohen nga Neni 24 i Shtojcës së LDHP-së. Kodi i Procedurës Kontestimore është i përgjithshëm dhe Ligji mbi Dhomën e Posaçme është ligj i posaçëm dhe si i tillë është mbizotërues.

Kriteri për përfaqësim nga një avokat nuk është shkelje e të drejtës kushtetuese të barazisë para ligjit. Mbetet çështje e hapur nëse AKP-ja si "organ publik" (Neni 1.1 Ligji mbi AKP-në) mund të argumentojë në lidhje me të drejtën themelore të barazisë, që është historikisht dhe në kontekstin e saj kushtetues e drejtë e personave fizik dhe entiteteve private juridike kundër shtetit, dhe jo e drejtë e një organi shtetëror kundër shtetit. I Padituri ka të drejtë të trajtohet në mënyrë të barabartë, por barazia kushtetuese nuk do të thotë se të gjithë trajtohen njësoj, pavarësisht nëse ato janë aspekte të arsyeshme dhe jo-diskriminuese të diferencimit. Nuk është as e paarsyeshme dhe as diskriminuese që të privilegjojnë personat fizik para gjykatës në raport me entitetet juridike (ose një autoritet shtetëror publik). Shpesh, nëse jo madje edhe rregullisht personat fizik nuk kanë mjete financiare për të përballuar avokatin. Kjo në kuadër të aspekteve kushtetuese është arsye e mjaftueshme për privilegjin e tyre për t'u paraqitur para DHPGJS-së pa një avokat.

Rrjedhimisht mund të thuhet se i Padituri, si të gjithë, përveç personave fizik, duhet të përfaqësohet para Dhomës së Posaçme nga një avokat i cili është anëtar i Shoqatës së Avokatëve ose Odës së Avokatëve. Pasi që i padituri nuk është përfaqësuar nga një avokat i regjistruar, duhet të konsiderohet se ai nuk është paraqitur fare në gjykatë.

2.

Megjithatë nuk është lëshuar asnjë Aktgjykim në Mungesë kundër të paditurit.

a.

Sa i përket tërheqjes së kërkesës së tij për t'u përfshirë në listën përfundimtare të privatizimit nga ana e paditësi, gjykatës nuk iu është dashur që të vendos në lidhje me përmbajtjen e kësaj kërkesë, por vetëm deklaron se padia është tërhequr (neni 261 i Kodit të Procedurës Kontestimore).

b.

Sa i përket kërkesave të tjera të Padisë, ato nuk janë të pranueshme dhe prandaj nuk mund të lëshohet një aktgjykim në mungesë (neni 52.2 i Shtojcës së LDHP-së).

Kërkesa për të vendosur në lidhje me pagën e paditësit prej datës 18.05.1994 deri më 10.07.2007 është e papranueshme pasi që paditësi nuk ka përcaktuar se çfarë shume në euro është duke kërkuar dhe si është llogaritur paga e tij. Deri më tani paditësi i ka propozuar gjykatës që të emëroj një ekspert. Tani për këtë çështje nevojitet një ekspertizë. Paditësi vetë ose avokati i tij duhet të sqarojnë se sa para është duke kërkuar dhe ata duhet të shpjegojnë si e kanë llogaritur rrogën e paditësit për periudhën kohore prej datës 18.05.1994 deri më 10.07.2007.

Gjithashtu kërkesa për të konfirmuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të datës 15.05.1994 është e papranueshme. Dhoma e Posaçme nuk ka juridiksion për të

konfirmuar aktgjykimin e formës së prerë të vitit 1994, i cili është nxjerrë nga një gjykatë e cila ka juridiksion sipas nenit 4.5 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme. Nëse vlefshmëria e një aktgjykimi të tillë për përmbartim nuk njihet, paditësi mund të ankohet apo ka mundur të ankohet në procedurën e përmbartimit pranë gjykatës e cila e ka ekzekutuar atë.

Nuk është në interesin ligjor të paditësit që gjykata të vendos që ai është emëruar në mënyrë të vlefshme si drejtor i NSH-së më 6 korrik 2004. Të paktën ai nuk ka kërkuar dhe nuk ka specifikuar një interes të tillë. Prandaj edhe kjo kërkesë është e papranueshme (neni 254.2 i Kodit mbi Procedurën Kontestimore).

Prandaj padia, pasi që nuk është tërhequr, është hedhur poshtë si e papranueshme.

Gjykata nuk i cakton shpenzime ankuesit meqë Presidiumi i Gjykatës deri më tani nuk ka nxjerrë planin me shkrim i cili miratohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (Neni 57 paragrafi 2 Ligji i Dhomës së Posaçme). Kjo do të thotë se deri tani nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore për vënien e shpenzimeve.

Këshilla ligjore

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet brenda 21 ditëve një ankesë pranë Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme. Ankesa do t'i dërgohet palëve të tjera dhe t'i dorëzohet Trupit Gjyqësor nga ana e Kolegjit të Apelit brenda 21 ditësh. Ankuesi do të dorëzojë pranë Kolegjit të Apelit një dëshmi se i ka dorëzuar ankesën palëve tjera.

Afati i paraparë fillon në mesnatën e asaj dite kur ankuesit i është dërguar aktvendimi me shkrim.

Kolegji i Apelit e refuzon ankesën si të papranueshëm nëse ankuesi nuk e parashtron atë brenda afatit të paraparë.

I padituri mund të parashtrrojë përgjigje tek Kolegji i Apelit brenda 21 ditëve nga data kur i është dërguar ankesa, duke e dorëzuar përgjigjen edhe tek ankuesi dhe tek pala tjetër.

Ankuesi pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja në ankesën e tij, për ta dorëzuar përgjigjen e vet tek Kolegji i Apelit dhe për ta dërguar atë tek pala tjetër. Pala tjetër pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja e ankuesit që të dorëzojë kundërpërgjigjen e tij tek ankuesi dhe tek Kolegji i Apelit.

Alfred Graf von Keyserlingk,
Gjyqtari Kryesues

[nënshkruar]